

UDHËZUES PËR PËRFSHIRJEN E EDUKIMIT PËR MEDIAN DHE INFORMACIONIN NË KURRIKULËN UNIVERSITARE

Qasja e të mësuarit përmes lëndës specifike
dhe integritit ndërlëndor



Albanian Media Institute
Instituti Shqiptar i Medias

Tiranë, 2023

Përgatitur nga:

Dr. Erlis Çela
Dr. Irena Myzeqari
Prof. Dr. Kseanela Sotirofski
Dr. Rrapo Zguri

Redaktor: **Agim Doksani**

©Instituti Shqiptar i Medias

Botues:



Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania
Tel./fax: ++ 355 4 2229800
E-mail: info@institutemedia.org
www.institutemedia.org

Ky udhëzues është realizuar si pjesë e projektit “Zhvillimi i Edukimit për Median dhe Informacionin për Mësuesit e Ardhshëm” të mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqesojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Përmbajtja

I. Hyrje	5
1.1 Çfarë është ky udhëzues?	5
1.2 Faktorët dhe rëndësia e përfshirjes së EMI-t në kurrikulën universitare	10
1.3 Përvoja e përfshirjes së EMI-t në kurrikulat shkollore dhe universitare	13
II. Qasjet kryesore për përfshirjen e EMI-t në kurrikulën universitare	17
2.1 Qasja e lëndës specifike për Edukimin për Median dhe Informacionin	17
2.2 Avantazhet dhe dezavantazhet e integritit të EMI-it si lëndë e veçantë	19
2.3 Qasja e integritit ndërlëndor të Edukimit për Median dhe Informacionin	22
2.4 Avantazhet dhe dezavantazhet e integritit ndërlëndor të EMI-t	23
2.5 Si mund të realizohet në lëndë të ndryshme?	25
III. Metodatat pedagogjike e të mësuarit e EMI	27
3.1 Të mësuarit e EMI-t përmes kërkimit	28
3.2 Të mësuarit e EMI-t përmes punës me projekte	30
3.3 Të mësuarit e EMI-t përmes rasteve studimore ...	32
3.4 Të mësuarit e EMI-t përmes të nxëniet bashkëpunues	34
3.5 Të mësuarit e EMI-t përmes analizës së tekstit	36

3.6	Të mësuarit e EMI-t përmes analizës kontekstuale	38
3.7	Të mësuarit e EMI-t përmes përkthimeve	40
3.8	Të mësuarit e EMI-t përmes Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit	41
3.9	Të mësuarit e EMI-t përmes eksperimenteve	43
IV. Sugjerime për hartimin e programit të lëndës së EMI-t		
4.1	Si mund të emërtohet/titullohet lënda?	46
4.2	Në cilin cikël studimi mund të ofrohet?	46
4.3	Sa është ngarkesa e rekomanduar e lëndës?	47
4.4	Çfarë kualifikimi duhet të kenë lektorët?	48
4.5	Si të përcaktohet qëllimi i lëndës në përputhje me programin e studimit?	49
4.6	Si të përcaktohen rezultatet e të nxënit për EMI-t?	50
4.7	Tematikat që mund të përfshihen në programin e lëndës	51
V. Sugjerime për planifikimin e integritit ndërlëndor të EMI-t		
5.1	Si të planifikoni integrimin e EMI-t në lëndët ekzistuese?	57
5.2	Si ta bëni EMI-n pjesë të qasjes pedagogjike?	62
5.2.1	<i>EMI si mënyrë për të aksesuar dhe vlerësuar burime të ndryshme informacioni</i>	62
5.2.2	<i>EMI si qasje për të nxitur zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik</i>	64
5.2.3	<i>EMI si metodë për të nxitur shprehjen dhe krijimtarinë e përmbajtjeve</i>	65
VI. Referenca		
		66

I.Hyrje

1.1 Çfarë është ky udhëzues?

Zhvillimet e dekadave të fundit në fushën e mediave dhe të informacionit, krahas dobisë së jashtëzakonshme e kanë ekspozuar njerëzimin edhe përpara sfidave dhe problemeve të panumërta. Në kërkim të zgjidhjeve për këto sfida dhe probleme, shkencëtarët dhe institucionet e kësaj fushe rekomandojnë mes të tjerash edhe promovimin dhe përhapjen e edukimit për mediat dhe informacionin (EMI). Siç thekson edhe studiuësja e njohur e kësaj fushe, Sue Ellen Christian, edukimi mediatik ofron mjetet dhe njohuritë me të cilat ne pajisemi për të jetuar në mënyrë të plotë dhe të ndërgjegjshme në kulturën e ndërlidhur të shekullit XXI.¹ Qysh në vitin 2005, Deklarata e Aleksandrias – një nga dokumentet e rëndësishme ndërkombëtare në fushën e EMI-t – e vendos edukimin për median dhe informacionin në zemër të procesit të të mësuarit përgjatë gjithë jetës.² Në një kuptim të gjerë EMI është pjesë e të mësuarit për jetën si edhe e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

1 Christian, Sue Ellen, *Edukimi mediatik në përditshmëri – Një udhëzues analog për jetën tuaj digjitale*, ISHM, Tiranë, 2022. f. 1.

2 *The Alexandria Proclamation on Information Literacy and Lifelong Learning*, (2005) Link: <https://milunesco.unaoc.org/mil-resources/the-alexandria-proclamation-on-information-literacy-and-lifelong-learning-2005/>

Përvoja e derisotme perëndimore tregon se një nga mënyrat më të efektshme për përhapjen e EMI-t në shoqëri është përfshirja e tij në sistemin arsimor, qoftë kjo si një lëndë e mëvetësishme, si përmbajtje e integruar në kurrikulën e lëndëve ekzistuese apo si metodologji mësimdhënieje.

Ky udhëzues është një dokument ndihmës që i shërben pikërisht përfshirjes së edukimit për median dhe informacionin (EMI) në kurrikulën e degëve të mësuesisë të universiteteve shqiptare.

Përfshirja e edukimit për mediat dhe informacionin në programin mësimor të degëve të mësuesisë të nivelit Bachelor apo Master të universiteteve shqiptare është një nismë që bazohet në këto premisa themelore:

Së pari, degët universitare të mësuesisë janë mjedisi ku krijohen mësuesit e ardhshëm të të gjitha specialiteteve që do të shërbejnë si mësimdhënës në shkollat 9-vjeçare apo ato të mesme. Duke u pajisur me njohuri dhe aftësi për EMI, kjo trupë arsimore e së ardhmes do të përbëjë edhe burimet njerëzore të nesërme për mësimdhënien e edukimit për median dhe informacionin.

Së dyti, ky fokus fillestar të mësuesit e ardhshëm përfaqëson një strategji kyçe për arritjen e një efekti shumëfishues: mësuesit i përcjellin njohuritë dhe aftësitë tek nxënësit e tyre dhe më tej tek shoqëria në përgjithësi. Mësuesit e arsimuar në media dhe informacion do të kenë kapacitete të zgjeruara për t'i fuqizuar nxënësit në përpjekjet e tyre në të mësuarit në mënyrë autonome

dhe ndjekjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Duke i edukuar nxënësit që të bëhen të aftë për median dhe informacionin, mësuesit do t'i përgjigjen së pari rolit të tyre si advokues të një qytetarie të informuar dhe racionale, dhe së dyti, ata do t'i përgjigjen ndryshimeve në rolin e tyre si edukatorë, duke e kthyer mësimdhënien nga një proces që kishte në qendër mësuesin, në një proces që ka në qendër nxënësin.³

Së treti, mësuesit kanë më shumë gjasa të përqafojnë kurrikulën e EMI-t pasi ajo lidhet me strategjitë pedagogjike që përmirësojnë mënyrën se si ata japin mësim edhe në lëndët tradicionale të shkollës. Nxitja e ndryshimeve në sektorin e arsimit që do të rezultojnë nga futja e EMI-t dhe ndikimi i tyre në zhvillimin profesional të mësuesve janë edhe synime të rëndësishme të këtij projekti.⁴

Bazuar në këto premisa, ky udhëzues ofron një kornizë hyrëse për pedagogët, zhvilluesit e kurrikulës, mësuesit, studentët dhe studiuesit, duke i njohur ata me temat dhe çështjet e EMI-t si dhe paraqet qëllimet e zhvillimit të mësimdhënies dhe të mësuarit të edukimit për median dhe informacionin.

Ai përshkruan rezultatet ose kompetencat e pritshme prej zhvillimit të EMI-t në degët e mësuesisë. Gjithashtu, udhëzuesi identifikon parimet kryesore, proceset dhe metodologjitë që duhen ndjekur gjatë hulumtimit, zhvillimit dhe zbatimit të një kurrikule për edukimin mbi median dhe informacionin.

3 *Media and Information Literacy - Curriculum for Teachers* (2011), UNESCO, f. 17.

4 Po aty.

Udhëzuesi rekomandon kornizat dhe qasjet pedagogjike përkatëse si dhe promovon të mësuarit profesional dhe përgjatë gjithë jetës të EMI-t. Njëherësh, ai ofron disa opsione për strategjitë e zbatimit të **kurrikulës së edukimit për median dhe informacionin.**

Përse hartohet?

Ky udhëzues synon t'u vijë në ndihmë institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri që janë të interesuara të përfshijnë edukimin për median dhe informacionin në kurrikulën e programeve të tyre të ciklit Bachelor dhe/ose Master. Ai ofron bazën konceptuale dhe kurrikulare për mësimdhënien dhe të mësuarit e EMI në degët apo programet universitare të mësuesisë.

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është që të promovojë përfshirjen e edukimit për median dhe informacionin në sistemin shkollor universitar duke e konsideruar këtë si një pikënisje dhe mënyrë efektive për përhapjen e njohurive dhe aftësive të EMI në shoqërinë shqiptare.

Ky udhëzues rekomandon që gjatë hartimit dhe zbatimit të programit të kurrikulave EMI, të merren parasysh edhe parimet kyçe të sugjeruara nga UNESCO, siç janë: promovimi i paqes dhe shmangia e gjuhës së urrejtjes, mbrojtja e të drejtave të njeriut, promovimi i sigurisë dhe i sundimit të ligjit, mbrojtja e diversitetit

kulturor dhe gjuhësor, balancimi dhe fuqizimi i qytetarëve përmes masave për t'i mbrojtur ata nga rreziqet, mbështetja e barazisë gjinore, zvogëlimi i barrierave për mirëkuptimin e ndërsjellë, ngushtimi i pabarazive dhe nxitja e pjesëmarrjes sociale dhe e tolerancës për të promovuar demokracinë dhe paqen.

Kujt i shërben?

Përfituesit e drejtpërdrejtë të nismës për hartimin e këtij Udhëzuesi janë institucionet e arsimit të lartë, zyrat apo drejtoritë e kurrikulave të këtyre institucioneve, pedagogët që do të përfshihen në mësimdhënien e plotë apo të pjeshme të EMI-t, si dhe të gjithë studentët e degëve të mësuesisë të universiteteve shqiptare.

Natyrisht në mënyrë të tërthortë nga kjo nismë përfitojnë edhe institucionet qeveritare arsimore, politikëbërësit dhe vendimmarrësit në fushën e arsimit, ekspertët e fushës si edhe gjithë pjesa tjetër e studentëve dhe e trupës akademike që nuk përfshihet drejtpërdrejt në mësimdhënien apo të mësuarit e EMI-t. Këta të fundit do të mund të përfitojnë edhe nga këndvështrimi i përdorimit të parimeve EMI, siç janë nxitja e të menduarit kritik dhe e aftësive krijuese, gjatë punës për hartimin e metodologjisë së mësimdhënies për lëndët e tjera.

Duke marrë në konsideratë efektet dhe ndikimin prapaveprues, nga ky Udhëzues pritet të përfitojnë edhe nxënësit e shkollave 9-vjeçare apo të mesme, të cilët në të ardhmen e afërt do të kenë mësues me kulturë më të gjerë mediatike, të mirinformuar dhe të pajisur me aftësitë e duhura të edukimit për median

dhe informacionin. Për rrjedhojë, efektet e kësaj nisme pritet të ndjehen edhe më gjerë në shtresat e ndryshme të shoqërisë.

Në një plan më konkret Udhëzuesi do të shërbejë si material ndihmës për:

- Grupin e punës në fakultetet e përfshira në Projekt, që do të hartojnë programin e lëndës me zgjedhje “Edukimi për Median dhe Informacionin”. Programi i lëndës këshillohet që të mbështetet tek kurrikula e hartuar në fazën e parë të projektit “Zhvillimi i Edukimit për Median dhe Informacionin në Universitetet Shqiptare”.
- Studentët e mësuesisë/stazhierët (mësuesit e ardhshëm) në Fakultetet e përfshira në Projekt, të cilët do ta përdorin EMI-n si mjet gjatë mësimdhënies në lëndë të ndryshme të arsimit parauniversitar, në përputhje me formimin e tyre pedagogjik.

1.2 Faktorët dhe rëndësia e përfshirjes së EMI në kurrikulën universitare

Faktorët që e bëjnë të domosdoshëm përhapjen e edukimit për median dhe informacionin mund t'i klasifikonim në faktorë globalë dhe faktorë lokalë. Ndër faktorët globalë që ndikojnë në këtë drejtim mund të përmendim:

Së pari, bumi i internetit, i gazetarisë online dhe i mediave të reja ka krijuar një ekosistem të dominuar nga info-obeziteti dhe së fundmi edhe nga infodemia.

Në këtë terren dezinformimi dhe lajmet e rreme po gjejnë gjithnjë e më shumë hapësirë. Nga ana tjetër algoritmet e mediave sociale me kalimin e kohës po e izolojnë përdoruesin në *information bubbles* [flluska informacioni] dhe në echo chambers [dhoma jehone], të cilat po ia zvogëlojnë atij dritaren e zgjedhjeve për t'u informuar dhe po krijojnë premisat që ai të shndërrohet nga "përdorues" në "i përdorur" prej tyre.

Së dyti, gjithnjë e më shumë është verifikuar se mediat paraqesin një realitet të rikonstruktuar dhe se mesazhi mediatik kalon përmes lenteve të interesave të ndryshme, përfshi këtu interesat ekonomike të pronarit, interesat politike apo ideologjike të spektrit mediatik përkatës dhe një numri të konsiderueshëm interesash të tjera që paraqiten si alternative ndaj interesit të përbashkët publik. Interesa të tilla alternative përcaktojnë shpesh axhendën e mediave.⁵

Së treti, mediat e reja dhe platformat online kanë krijuar hapësira për çdo individ që të botojë apo shpërndajë informacion, pavarësisht nga njohja që ka për rregullat e të shkruarit për mediat dhe standardet e komunikimit masiv. E ashtuquajtura "përmbajtje e gjeneruar nga përdoruesit" (anglisht: *user generated content*) zë tashmë një pjesë të konsiderueshme të ekosistemit online dhe shpesh krijon "ndotje" në këtë ekosistem, edhe për shkak të mungesës së njohurive dhe përvojës mediatike të përdoruesve.

5 Zguri, Rrapo, *Kultivimi i literacisë së medias dhe të informacionit në mjediset universitare*, ISHM, Tiranë 2022, Link: <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2021/03/Rrapo-Zguri.pdf>

Ndërkohë, kur bëhet fjalë për nevojën e përhapjes së edukimit mediatic në Shqipëri, krahas faktorëve globalë, një rol të konsiderueshëm luajnë edhe faktorët lokalë, si tradita e zbehtë e kulturës mediatike dhe kuptimi i mangët mbi mediat, specifikat, funksionin dhe rolin e tyre në shoqëri që ka bërë që në një shkallë të konsiderueshme njerëzit të mendojnë sipas medias dhe të mbrojnë argumentin e tyre apo të hedhin poshtë argumentin e tjetrit duke u bazuar në informacionin e marrë nga mediat.

Këta faktorë, dhe të tjerë të natyrave të ndryshme, kanë sjellë në rend të ditës si kurrë ndonjëherë më parë nevojën për edukimin për median dhe informacionin.

Rëndësia e EMI-t qëndron në faktin se përmes tij zhvillohet tek individët dhe sidomos tek brezi i ri të menduarit kritik në raport me median, aftësia për të dekonstruktuar mesazhin mediatic dhe për të lexuar përtej rreshtave të këtij mesazhi, njohuritë dhe shprehitë e duhura që kërkohen për të dalluar njëanshmërinë, keqinformimin, dezinformimin apo lajmet e rreme, për të zbuluar atë që nuk është thënë apo që është nxjerrë nga konteksti, për të identifikuar reklamat e fshehura apo informacionin që vjen nga zyrat e PR, për të zhvilluar aftësitë krijuese në lëmin e medias dhe së fundmi për të reaguar dhe advokuar për ndryshim të sistemit mediatic.⁶

6 Zguri, Rrapo, *Kultivimi i literacisë së medias dhe të informacionit në mjediset universitare*, ISHM, Tiranë 2022, Link: <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2021/03/Rrapo-Zguri.pdf>

1.3 Përvoja e përfshirjes së EMI në kurrikulat shkollore dhe universitare

Sonia Livingstone, një nga studiueset pioniere të fushës së EMI, përmend disa qasje të edukimit rreth EMI-it në sistemin arsimor. Sipas saj vende të ndryshme e kanë përfshirë edukimin mbi median në shkolla si pjesë të axhendave të caktuara.

Në disa raste edukimi mbi median është mësuar në shkolla për dekada të tëra si pjesë e një axhende proteksioniste, duke synuar t'u mësojë fëmijëve që të jenë kritikë dhe të kujdesshëm duke i mbrojtur përballë kulturës masive. Ndërkohë një qasje e dytë ka të bëjë me një axhendë krijuese, e cila synon të pajisë fëmijët dhe nxënësit me njohuri që do t'i ndihmojë ata të vlerësojnë format dhe zhanret e ndryshme të përmbajtjes së medias, si dhe të zgjerojnë kuptimin e tyre estetik dhe kritik ndaj tyre. Një qasje më e re që ka udhëhequr përfshirjen e edukimit mbi median në shkolla mund të përmbledhet në atë që cilësohet si axhenda e fuqizimit. Sipas kësaj qasje më të re, qëllimi i përfshirjes së njohurive rreth medias në kurrikulat e shkollave synon aftësimin e të rinjve në përdorimin e mjeteve teknologjike të vetë-shprehjes duke rritur pjesëmarrjen e tyre në shoqërinë moderne.

Krahas vëzhgimit të studiuesve si Livingstone mbi historikun e përfshirjes së njohurive për median në kurrikulat shkollore si pjesë e një kornize me disa qasje,

studiues të tjerë janë përpjekur të konceptojnë modele sa më produktive të integritit të EMI-it në sistemin arsimor.

UNESCO si një nga institucionet më aktive në fushën e edukimit për median dhe informacionin është përqendruar në hartimin e modeleve sa më gjithëpërfshirëse, të cilat mund të përshtaten sipas konteksteve të ndryshme sociale.

Ndërkohë zhvillimi i EMI-t brenda sistemit shkollor ndryshon jo vetëm nga një vend në tjetrin, po mund të ndryshojë edhe nga një shkollë në tjetrën. Nuk mund të ketë një kornizë globale unike për zhvillimin e EMI, për arsye se ai duhet të ketë parasysh dhe të përshtatet edhe me kontekstin kulturor të një vendi, me llojin e sistemit të tij arsimor, me traditën e mësimdhënies, me nivelin e studimeve ku aplikohet, etj.

Studiuesja e njohur Renee Hobbs në një intervistë të vitit 2019 për Blumberg, vëren se “Edukimi mediatik në një shkollë urbane publike do të duket i ndryshëm nga edukimi mediatik në një shkollë të pasur dhe të mirëpajisur, të cilat nga ana e tyre do të duken të ndryshme nga edukimi mediatik si program jashtëshkollor apo i bibliotekës. Edukimi mediatik në Kinë dhe edukimi mediatik në Lindjen e Mesme do të duken të ndryshëm nga ai që ne shohim në Brazil, Kanada, Britani apo Shtetet e Bashkuara. Nuk ka vetëm një mënyrë të drejtë për ta realizuar atë”.⁷

⁷ Blumberg, F. C. (2019). Media literacy for the 21st century: Interview with Renee Hobbs, EdD. *Society for Media Psychology & Technology, Division 46 of the American Psychological Association*. Spotlights feature.

Nga ana tjetër EMI “i fuqizon njerëzit në të gjitha sferat e jetës për të kërkuar, vlerësuar, përdorur dhe krijuar informacion në mënyrë efektive për të arritur qëllimet e tyre personale, sociale, profesionale dhe arsimore. Është një e drejtë themelore e njeriut në një botë dixhitale dhe promovon përfshirjen sociale të të gjitha kombeve.”⁸

Përfshirja e EMI në kurrikulat universitare të vendeve perëndimore është një proces i zhvilluar kryesisht gjatë dy dekadave të fundit. Përvojat në këtë drejtim janë nga më të ndryshmet.

Universiteti i Lapland në Finlandë ofron një program dyvjeçar të nivelit Master në edukimin mediatik. Në të njëjtin Universitet është ngritur njësia e Media Education Hub me një përvojë 15-vjeçare në ndërmarrjen e projekteve kërkimore ndërdisiplinore dhe në zhvillimin e modeleve të edukimit mediatik për kontekste të ndryshme.⁹

Një program i nivelit Master në edukimin për median dhe informacionin është hapur edhe në Vidzeme University të Letonisë. Programi ofron një set njohurish dhe kompetencash që nevojiten për kërkimin, analizimin dhe vlerësimin e përmbajtjes së mediave të çdo lloji dhe formati.¹⁰

8 *The Alexandria Proclamation on Information Literacy and Lifelong Learning*, (2005), Link: <https://milunesco.unaoc.org/mil-resources/the-alexandria-proclamation-on-information-literacy-and-lifelong-learning-2005/>

9 <https://www.ulapland.fi/EN/Units/Media-Education-Hub>

10 <https://va.lv/en/study-here/masters-degree/media-and-information-literacy/about-programme>

Ndërsa College of Education i Universitetit të Uashingtonit e ka ngritur në nivel instituti mësimdhënien në fushën e edukimit për informacionin. E emërtuar Media Literacy Institute, kjo njësi mësimdhënieje e konsideron urgjente nevojën e përvetësimit të aftësive mediatike nga ana e studentëve, veçanërisht të aftësive të menduarit kritik, vlerësimit dhe ndarjes së informacionit. Sipas themeluesve të këtij Instituti, edukimi për median nuk është vetëm një lëndë e rëndësishme për t'u mësuar – ai është edhe një mënyrë tërheqëse për të mbështetur mësimin e të gjitha lëndëve.¹¹

Universiteti i Utrechtit në Holandë dallohet për kurset e trajnimit online në fushën e edukimit për informacionin. Programi Compass + i zhvilluar në këtë universitet, është i mirënjohur për ndjekje të konsiderueshme dhe për metodat interesante të mësimdhënies.¹²

Në një qasje tjetër, Universiteti i Greifswald në Gjermani e organizon mësimdhënien në fushën e edukimit për informacionin në formën e trajnimeve që organizohen si nga Instituti përkatës edhe nga biblioteka e universitetit. E veçanta e këtyre kurseve është se në to trajnohen jo vetëm studentë, por edhe staf akademik.¹³

11 <https://education.uw.edu/programs/courses/media-literacy-institute-2022>

12 <https://www.uu.nl/en/university-library/advice-support-to/students/information-literacy-skills/compass-online-training-course-information-literacy-skills>

13 <https://ub.uni-greifswald.de/en/service/other-services/training-in-information-literacy/>

II. Qasjet kryesore për përfshirjen e EMI-t në kurrikulën universitare

Edukimi mbi median dhe informacionin mund të përfshihet në kurrikulën universitare përmes dy qasjeve kryesore¹⁴. Qasja e parë ka të bëjë me konceptimin e një lëndë të veçantë e cila u ofrohet studentëve si pjesë formuese e programit të studimit. Qasja e dytë ka të bëjë me integrimin ndërlëndor të EMI-it, që nënkupton përfshirjen dhe trajtimin e kësaj fushe në mënyrë të koordinuar brenda programeve të lëndëve ekzistuese. Ky udhëzues propozon këto dy qasje kryesore për përfshirjen e EMI-t në kurrikulën e programeve të studimit në universitet.

2.1 Qasja e lëndës specifike për Edukimin për Median dhe Informacionin

Përfshirja e njohurive rreth edukimit mbi median dhe informacionin si lëndë e veçantë në kurrikulën e programeve universitare, përbën një nga qasjet kryesore për t'i dhënë mundësi studentëve në nivelin e parë dhe të dytë të studimeve të përfitojnë njohuri dhe kompetenca

¹⁴ *Implementation and Evaluation of a Media Literacy Skills Curriculum: An Action Research Study*, Cahit Erdem, Bahadır Erişti, *International Journal of Modern Education Studies*, 2022, Volume 6, No 1, Pages: 20-50

në këtë fushë. Kjo qasje nënkupton përfshirjen e njohurive EMI brenda një lëndë të veçantë, e cila mund të ofrohet si lëndë me zgjedhje ose lëndë e detyrueshme. Lënda ka ngarkesën e saj të krediteve ECTS, objektivat dhe rezultatet e të nxënit. Në këtë rast duhet të mbahet parasysh fakti se objektivat e lëndës dhe rezultatet e të nxënit duhet të integrohen me objektivat dhe rezultatet e përgjithshme të programit të studimit. Për këtë arsye fillimisht është e nevojshme të bëhet një vlerësim i detajuar i objektivave formuese dhe rezultateve të programit të studimit me qëllim identifikimin e pikave që mund të përmbushen përmes lëndës së EMI-it. Duke pasur parasysh kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për elementët e programeve të studimit, ekzistojnë dy kategori ku mund të integrohet kjo lëndë¹⁵. Njësia bazë e cila propozon përfshirjen e lëndës së EMI-it në kurrikulën e programit mund të propozojë që kjo lëndë të përfshihet në kategorinë “A”, komponenti mësimor i së cilës është “lëndë bazë – Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme”. Kjo alternativë nënkupton së lënda është pjesë e grupit të lëndëve të detyrueshme që studentët duhet të marrin gjatë ciklit të studimit. Mundësia e dytë është përfshirja e lëndës së EMI-it në kategorinë “C”, e cila përfshin komponentin mësimor “Lëndë ndërdisiplinore/Integruese – Nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje”.

15 VKM “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/6.-vendim-2021-03-25-185.pdf>

2.2 Avantazhet dhe dezavantazhet e integritit të EMI-it si lëndë e veçantë

Pavarësisht kategorisë në të cilën përfshihet një lëndë e tillë, qasja për të ofruar EMI-in si lëndë e veçantë në programet e studimit në fushën e edukimit nënkupton një ndërhyrje më të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë për plotësuar vakuumin e njohurive dhe kompetencave të një brezi, i cili është i ekspozuar ndaj medias dhe informacionit në një shkallë shumë të lartë. Nëse për brezat e ardhshëm mund të krijohet mundësi të marrin informacion rreth EMI-it dhe të fitojnë kompetenca të nevojshme, në ciklet e arsimit parashkollor, për studentët kjo është pamundur. Për këtë arsye, kërkohet një ndërhyrje me efekt të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë. Një lëndë e veçantë do të ketë një impakt të tillë te studentët. Brenda programit të lëndës ata do të kenë një listë të plotë temash që mbulon çështjet kryesore të edukimit mbi median dhe informacionin. Studentët do mund të marrin një formim të plotë dhe konkret për median dhe informacionin, që do t'i ndihmojë në formimin e kompetencave të nevojshme për t'u përballur me dukuri negative si lajmet e rreme, teoritë konspirative, si dhe për të prodhuar përmbajtje në mënyrë etike dhe vlerësuar përmbajtjet që ofrohen nga burime dhe platforma të ndryshme.

Ndërkohë si dezavantazh në këtë rast mund të shihet përshtatshmëria e kësaj lënde me profilin e programit të studimit. Nisur nga ky fakt mbetet e rëndësishme që njësia bazë të bëjë një studim paraprak për të

identifikuar tematikat specifike të fushës së studimit, të cilat mund të përfshihen në planin e lëndës së edukimit mbi median dhe informacionin. Në përputhje me programin e studimit, plani i lëndës duhet të përfshijë tema, raste studimore, ushtrime dhe punë laboratorike që përputhen me profilin e programit të studimit.

Kjo punë paraprake ndihmon për të krijuar një lëndë të përshtatshme me profilin e studimit, si dhe rrit interesin e studentëve, të cilët do të gjejnë brenda lëndës tematika me të cilat janë të familjarizuar. Në këtë mënyrë, mund të shmanget perceptimi se lënda nuk ka lidhje me formimin e tyre dhe programin në të cilin studiojnë.

Aplikimi i EMI-t si lëndë e veçantë në kurrikulat e programeve të studimit me fokus edukimin, duhet të synojë përfshirjen e tematikave që ndërlidhen me të tre nivelet e EMI-t;

- Njohuri dhe të kuptuarit e medias dhe informacionit për diskutet demokratike dhe pjesëmarrjen sociale,
- Vlerësimi i teksteve mediatike dhe burimeve të informacionit,
- Prodhimi dhe përdorimi i medias dhe informacionit.

Programi i lëndës mund të përfshijë qasjen e bazuar në kompetenca, e cila synon aftësimin e studentëve në drejtim të aksesit, analizimit, vlerësimit dhe krijimit apo prodhimit të përmbajtjeve në një larmi formash. Spektri i kompetencave apo aftësive që mund të përfshihen gjatë hartimit të programit, mund të zgjerohet bazuar në disa

modele të sugjeruara nga institucione të specializuara dhe studiuesit e fushës. Modeli i UNESCO-s parashikon shtatë kompetenca kryesore. Sipas këtij modeli kurrikula duhet të ndërtohet duke marrë parasysh kompetencat e mëposhtme:

- Kuptimi i rolit të informacionit, medias dhe komunikimeve dixhitale në zhvillimin e qëndrueshëm dhe demokraci
- Kuptimi i përmbajtjes dhe përdorimit të medias
- Vlerësimi paraprak i informacionit me efikasitet dhe përdorimi i etikës
- Vlerësimi kritik i informacionit, burimeve të informacionit dhe praktikave etike
- Vënia në zbatim e formateve mediatike dixhitale dhe tradicionale
- Përcaktimi i kontekstit socio-kulturor të përmbajtjes informuese, mediatike dhe dixhitale
- Promovimi i EMI te nxënësit / qytetarët dhe menaxhimi i ndryshimeve të kërkuara

Ndërsa modeli i propozuar nga studiuesi James Potter përfshin qasjen e bazuar në shtatë aftësi¹⁶. Sipas tij, krahas mendimit kritik, shtatë aftësitë e tjera që mund të përfitohen nga EMI janë; aftësia e analizës, vlerësimit, grupimit, induksionit, deduksionit, sintezës dhe abstragimit. Ndërkohë në një model tjetër të propozuar nga studiuesja Sue Ellen Christian përfshihen disa elementë që përbëjnë Edukimin mbi Median dhe Informacionin në shoqëritë digjitale¹⁷. Këto elementë

16 *Media Literacy*, Tenth Edition, W. James Potter, Sage Publications, 2021

17 Christian, Sue Ellen, *Edukimi mediatik në përditshmëri – Një udhëzues analog për jetën tuaj digjitale*, ISHM, Tiranë, 2022

janë, përdorimi, të menduarit, verifikimi, analiza, krijimi, shpenzimi, lidhja, informimi, mbrojtja, zgjedhja dhe pjesëmarrja. Kuadri i elementëve që propozon Christian mund të shërbejë si kornizë e kompetencave që duhet të fitojë studenti nga lënda e EMI-it, gjatë një semestri. Temat e përfshira në silabusin e lëndës duhet të përzgjidhen me qëllim përfitimin e këtyre aftësive nga ana e studentëve.

2.3 Qasja e integritit ndërlëndor të Edukimit për Median dhe Informacionin

Edukimi për Median dhe Informacionin synon të ndihmojë individët e të gjitha moshave të zhvillojnë dhe ushqejnë veten e tyre me rëndësinë e të menduarit kritik, të komunikuarit të qenësishëm dhe aktivizmit për një botë më të mirë. Pikërisht, zhvillimi i këtyre kompetencave te studentët dhe mësuesit e së ardhmes kërkon arsimim të integruar. Programet e reja mësimore operojnë mbi parimin e integritit dhe përshtatjes, që do të thotë se aftësitë e marra në një lëndë, duhet të mirintegrohen me kompetencat e tjera. Integrimi i Edukimit për Median dhe Informacionin si një lëndë me zgjedhje ka rezultuar një qasje shumë efektive, megjithatë njohuritë dhe kompetencat që ajo zhvillon, mund të integrohen edhe në më shumë lëndë dhe fusha të tjera të të nxënies. Në këtë kontekst, sugjerohet që gjatë planifikimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, në përzgjedhjen e veprimtarive mësimore, pedagogu/ mësuesi, duhet

të marrë në konsideratë integrimin ndërlëndor më një shumësi fushash formimi. Në dallim nga qasja e parë, e detajuar në hyrje të këtij kapitulli, qasja ndërlëndore, si modul apo e ndërthurur me lëndë të tjera, nuk kërkon një planifikim paraprak se në cilët komponentë mësimorë do të përfshihet, të lëndëve bazë apo me zgjedhje, por kërkon një predispozitë të veçantë nga vetë pedagogu i kursit, në hartimin e silabusit të lëndëve përkatëse, për të parë se ku dhe si mund të integrohet EMI.

2.4 Avantazhet dhe dezavantazhet e integritit ndërlëndor të EMI-t

Qasja për të ofruar EMI-n si një modul të lëndë të caktuara nënkupton një ndërhyrje më të tërthortë dhe më të shtrirë në kohë, për të plotësuar njohuritë dhe kompetencat e munguara të gjeneratës sonë. Praktikrat më të mira perëndimore synojnë ta integrojnë dhe prezantojnë EMI-n qysh herët në arsimimin e brezave të rinj, por duke qenë se studentët në vendin tonë nuk kanë qenë mjaftueshëm të ekspozuar ndaj Edukimit për Median dhe Informacionin, integrimi ndërlëndor do të rriste shanset e aftësimin në këtë aspekt. Integrimi si një modul me 3- 4 tema brenda silabuseve të ndryshme të programit të tyre të studimit, do t'u mundësonte atyre të dëgjonin dhe mësonin më shumë për EMI-n në kontekste të ndryshme të të nxënit, ku do të kishin mundësi të reflektonin për përthyerjet e kësaj fushe studimi me fusha të tjera. Po në këtë linjë, mund të të avancohet një hap më tej, duke aftësuar pedagogët të

punojnë me integrimin ndërlëndor të EMI-t jo vetëm si modul, por të ndërtonin të tërë silabusin duke përdorur EMI-n si një qasje metodike dhe përcaktimin e qartë të rezultateve të të nxënit duke u nisur nga kjo qasje. Thënë kjo, integrimi ndërlëndor do të pasuronte ndjeshëm aftësitë e tyre në njohjen, verifikimin dhe përdorimin e informacionit dhe se si mund ta operacionalizonin atë në fusha të ndryshme të dijes dhe kërkimit.

Ndërkohë që avantazhet e kësaj qasje janë evidente, sepse studenti përballet me EMI-n nga shumë kënde dhe perspektiva, ekzistojnë disa sfida, të cilat kanë nevojë të adresohen herët, për të parandaluar efekte të mundshme negative në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Nisur nga ky fakt është e rëndësishme të bëhet një punë paraprake për të parë se cilat lëndë kanë më shumë hapësirë për integrim ndërlëndor, qoftë si modul apo si metodë. Elementi tjetër i rëndësishëm ku duhet punuar është shtypa institucionale për të bërë pedagogët të kuptojnë rëndësinë e integritit ndërlëndor me EMI-n dhe kjo mund të realizohet me vendime kolegjiale, të cilat ftojnë departamentet të reflektojnë vlerën e qasjes ndërlëndore në kurrikulën dhe silabuset e lëndëve të tyre. E fundit por jo më pak e rëndësishme, qasja ndërlëndore është më e vështirë të faktohet dhe matet, ndaj është detyrë e vetë stafeve, të përcaktojnë instrumente të qartë matës, si të rezultateve të të nxënit, ashtu edhe të implementimit të kësaj qasjeje në nivel institucional.

2.5 Si mund të realizohet në lëndë të ndryshme?

Sipas studimeve në komunikim dhe jo vetëm, gjenerata e studentëve sot është jo vetëm konsumuese e informacionit, por edhe krijuese edhe shpërndarëse e informacionit. Për atë që mund të tingëllojë si sfida, kjo prirje është edhe një mundësi e jashtëzakonshme, sepse lehtëson ndjeshëm edukimin për median dhe informacionin në kurrikulën ekzistuese, në një shumësi temash dhe e kthen atë në një mjet shumë efikas për të eksploruar më shumë qasjet e reja ndërdisiplinore në edukim. Duke ditur se EMI ndikon fuqishëm në rritjen e kapaciteteve individuale për një qytetari më aktive, mund të themi se disa nga mënyrat më të mira se si ai mund të integrohet në lëndë të ndryshme janë:

- ✓ Duke praktikuar vëzhgimin dhe të menduarin kritik.
- ✓ Duke i ftuar studentët të reflektojnë se si njohuritë që kanë në një fushë të dhënë janë të ndikuara dhe ndërtuara nga mediumet.
- ✓ Duke përfshirë mediumet si një mjet kryesor pedagogjik të shtrirë në të gjithë orët e silabusit.
- ✓ Duke rritur kapacitetet kërkuese dhe analizuese të studentëve.

Kjo qasje në dallim nga qasja e parë, kërkon studentë dhe pedagogë më aktivë për të analizuar dhe reflektuar mbi median, sepse zgjeron ndjeshëm konceptin e edukimit në të gjitha format e të komunikuarit. Duke qenë

se është qasje e shtrirë horizontalisht, bën të mundur që studentët të jenë thuajse gjatë gjithë vitit, dhe në të gjitha nivelet, në përballje të vazhdueshme me EMI-n e për rrjedhojë, të fillojnë të kuptojnë se media është pjesë integrale e kulturës kur ata formësohen personalisht dhe profesionalisht.

III. Metodatat pedagogjike për të mësuarit e EMI-t

Trajnimi i kandidatëve për mësues për edukimin për median dhe informacionin është një sfidë e madhe për sistemin arsimor global të paktën për dekadën e ardhshme.

Edukimi për median dhe informacionin përfshin shumë kompetenca, nga të mësuarit dhe përdorimi i teknologjive të komunikimit të informacionit deri te të menduarit në mënyrë kritike për etikën dhe demokracinë. Edukimi për median dhe informacionin është edhe një fushë e përmbajtjes dhe mënyrë e mësimdhënies dhe të nxënit dhe jo vetëm përvetësimi i aftësive teknike, por edhe zhvillimi i një kuadri qasjesh kritike.

Metoda pedagogjike e medias dhe informacionit përfshin pajisjen e studentëve me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme për të lundruar, analizuar dhe përdorur në mënyrë efektive informacionin në peizazhin e sotëm mediatik që evoluon me shpejtësi. Kjo përfshin aftësimin e studentëve se si të aksesojnë, vlerësojnë dhe përdorin forma të ndryshme të medias dhe informacionit, të tilla si artikuj lajmesh, postime në media sociale, video dhe podkaste.

Për të mësuar median dhe informacionin në mënyrë efektive, pedagogët mund të ndjekin një sërë strategjish apo të përdorin metoda dhe mjete mësimore të ndryshme.

Gjatë hartimit të planit mësimor për mësimdhënien e medias dhe informacionit, sugjerohet ndjekja e një kornize kritike duke marrë parasysh teorinë e konstruktivizmit social ku i gjithë informacioni ndërtohet nga individë dhe grupe njerëzish që bëjnë zgjedhje brenda konteksteve sociale, gjuhët/semiotika specifike e përdorur, audienca, politika e përfaqësimit, qëllimi i teksteve mediatike dhe sistemet brenda të cilëve veprojnë. Për të realizuar qëllimin e mësimin të medias dhe informacionit dhe konkretizimin e përdorimit në mënyrë korrekte të saj, mësimdhënësit sugjerohen të përdorin një sërë metodash pedagogjike.

Duke mos i limituar metodat pedagogjike me ato të ilustruara më poshtë, gjatë hartimit të planit mësimor për EMI-n si lëndë e veçantë ose e integruar në lëndë të tjera, përdorimi i metodave më poshtë është identifikuar i suksesshëm gjatë mësimdhënies.

3.1 Të mësuarit e EMI përmes kërkimit

Mësimdhënia e EMI-t përfshin aftësimin e studentëve për të zhvilluar aftësitë e të menduarit kritik dhe aftësinë për të analizuar dhe vlerësuar mesazhet mediatike. Një mënyrë efektive për të përmirësuar mësimdhënien për median dhe komunikimin është përfshirja e kërkimit në procesin e mësimdhënies. Disa këshilla për përdorimin e kërkimit për të mësuar median dhe informacionin janë si më poshtë:

- Filloni duke përkufizuar edukimin mediatik dhe rëndësinë e tij. Shpjegoni pse është thelbësore të jesh i arsimuar mediatikisht në botën e sotme. Përcaktoni cilat aftësi dhe njohuri janë të nevojshme për të qenë i edukuar mbi median dhe informacionin.
- Përdorni shembuj të jetës reale, p.sh mesazhe mediatike konkrete, për t'i ndihmuar studentët të kuptojnë fuqinë e medias dhe se si ajo mund të formësojë perceptimet dhe bindjet tona. Analizoni lloje të ndryshme mediash, duke përfshirë reklamat, artikujt e lajmeve, shfaqjet televizive, filmat dhe mediat sociale.
- Nxisni studentët të kryejnë kërkimin e tyre dhe të përdorin aftësitë e të menduarit kritik për të analizuar dhe vlerësuar mesazhet mediatike. Jepuni atyre burime të tilla si revista akademike, artikuj lajmesh dhe burime në internet për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësi kërkimore.
- Kërkojuni studentëve të krijojnë mesazhet e tyre mediatike, të tilla si reklama, postime në media sociale ose video. Nxitini ata të zbatojnë atë që kanë mësuar rreth edukimit mediatik për të krijuar mesazhe që janë informuese, të sakta dhe etike.
- Përdorni studime të rasteve për të ilustruar se si mesazhet mediatike mund të manipulohen, shtrembërohen ose paragjyken. Diskutoni se si organizatat mediatike mund të kenë një axhendë të fshehur dhe se si mesazhet mediatike mund të

ndikohen nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë politikën, ekonominë dhe normat kulturore.

- Jepuni mundësi studentëve që të ndajnë gjetjet dhe njohuritë e tyre kërkimore me kolegët. Nxitini ata të përfshihen në diskutime dhe debate të hapura rreth çështjeve të medias dhe të marrin në konsideratë perspektiva dhe këndvështrime të ndryshme.
- Së fundmi, vlerësoni aftësitë e studentëve për edukimin mediatik duke u kërkuar atyre të analizojnë dhe vlerësojnë në mënyrë të pavarur mesazhet mediatike. Përdorni rubrika ose mjete të tjera vlerësimi për të dhënë komente dhe për t'i ndihmuar ata të përmirësojnë aftësitë e tyre të menduarit kritik.

Përmes përfshirjes së kërkimit në procesin e mësimdhënies, ju mund t'i ndihmoni studentët të zhvillojnë aftësi të menduarit kritik, të bëhen më të informuar rreth medias dhe të kuptojnë më mirë fuqinë e medias në formësimin e perceptimeve dhe besimeve të tyre.

3.2 Të mësuarit e EMI-t përmes punës me projekte

Të mësuarit e EMI-t përmes projekteve mund të jetë një mënyrë efektive për t'i ndihmuar studentët të zhvillojnë

aftësi të të menduarit kritik, të kuptojnë mesazhet mediatike dhe të bëhen konsumatorë më të informuar të medias.

Këtu janë disa hapa kryesore për zbatimin e të nxënit të bazuar në projekte në një kurrikul të edukimit për median dhe informacionin:

- **Përcaktoni qëllimet mësimore:** Filloni duke vendosur objektiva të qarta mësimore për projektin. Për shembull, të mundësojë që studentët të jenë në gjendje të analizojnë mesazhet mediatike, të identifikojnë paragjykimet e medias ose të krijojnë përmbajtjen e tyre mediatike. Këto qëllime duhet të udhëheqin pjesën tjetër të planifikimit të projektit.
- **Zgjidhni formatin e medias:** Në varësi të qëllimeve mësimore dhe burimeve të disponueshme, mund të zgjidhni të përqendroheshi në lloje të ndryshme mediash, si lajmet televizive, mediat sociale ose reklamat në internet.
- **Planifikoni projektin:** Hartoni një projekt që i lejon studentët të angazhohen me formatin e zgjedhur të medias në një mënyrë kuptimplote. Për shembull, mund t'u kërkoni studentëve të analizojnë mesazhet e medias duke krijuar një ditar mediatik, ku ata regjistrojnë dhe reflektojnë mbi konsumin e tyre mediatik gjatë një periudhe kohore. Njëkohësisht, studentët mund të krijojnë përmbajtjen e tyre mediatike, të tilla si një fushatë në media sociale ose një njoftim për shërbimin publik me video.

- **Skeleti i të mësuarit:** Sigurojuni studentëve burimet dhe mbështetjen që u nevojitet për të përfunduar me sukses projektin. Kjo mund të përfshijë ofrimin e informacionit bazë mbi edukimin mediatik, modelimin e teknikave të analizës ose ofrimin e komenteve dhe udhëzimeve gjatë gjithë projektit.
- **Reflektoni dhe vlerësoni:** Pas përfundimit të projektit, jepuni mundësi studentëve që të reflektojnë mbi të nxënë të tyre dhe të vlerësojnë punën e tyre. Kjo mund të përfshijë rishikim nga kolegët, vetëvlerësim ose një diskutim në klasë.

Përmes kësaj metode, studentët mund të zhvillojnë aftësitë e EMI-t duke fituar gjithashtu përvojë në bashkëpunim, zgjidhje të problemeve dhe komunikim. Duke u ofruar studentëve mundësi për t'u angazhuar me median në një mënyrë kuptimplotë, ata mund të bëhen konsumatorë apo krijues të informuar dhe të përgjegjshëm të medias.

3.3 Të mësuarit e EMI-t përmes rasteve studimore

Të mësuarit përmes rasteve studimore është një mënyrë efektive për t'i ndihmuar studentët të kuptojnë mënyrat komplekse në të cilat media ndikon në mendimet,

besimet dhe veprimet e tyre. Duke shqyrtuar shembuj nga jeta reale të mesazheve mediatike dhe ndikimin e tyre, studentët mund të zhvillojnë aftësi të menduarit kritik dhe të mësojnë të analizojnë përmbajtjen e medias në një mënyrë më të informuar dhe më të balancuar.

Këtu janë disa hapa që mund të ndërmerrni për të mësuar EMI-n përmes studimit të rasteve:

- ✓ Zgjidhni një shumëllojshmëri rastesh studimore që pasqyrojnë formate të ndryshme mediatike (p.sh. artikuj lajmesh, reklama, postime në media sociale) dhe tema të ndryshme (p.sh. politika, shëndetësia, produktet e konsumit).
- ✓ Prezantoni studentët me rastin e studimit dhe jepuni atyre informacion mbi përmbajtjen e medias dhe kontekstin e saj. Nxisni studentët të bëjnë pyetje dhe të identifikojnë çdo paragjykim ose supozim në mesazhin mediatik.
- ✓ Udhëzoni studentët në analizimin e përmbajtjes së medias duke u kërkuar të identifikojnë mesazhin që përcillet, audiencën e synuar dhe teknikat e përdorura për të përcjellë mesazhin (p.sh. gjuha, imazhet, toni).
- ✓ Nxisni studentët të eksplorojnë ndikimin e përmbajtjes së medias duke u kërkuar atyre të marrin në konsideratë se si ajo mund të ndikojë në besimet dhe sjelljet e njerëzve dhe çfarë pasojash mund të rezultojnë nga këto ndryshime.
- ✓ Lehtësoni një diskutim në grup në të cilin studentët ndajnë pikëpamjet dhe këndvështrimet e tyre

mbi rastin e studimit dhe nxitini ata të reflektojnë mbi atë që kanë mësuar rreth edukimit mediatik.

Duke përdorur raste studimore për të mësuar median dhe informacionin, ju mund t'i ndihmoni studentët të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, të përmirësojnë aftësitë e tyre të EMI-t dhe të bëhen konsumatorë më të informuar të përmbajtjes mediatike.

3.4 Të mësuarit e EMI-t përmes të nxënit bashkëpunues

Mësimdhënia e medias dhe informacionit përmes të nxënit bashkëpunues mund të jetë një mënyrë efektive për të angazhuar studentët në mendimin kritik dhe analizën e medias që ata konsumojnë. Të mësuarit bashkëpunues përfshin studentët që punojnë së bashku në grupe të vogla për të arritur një qëllim të përbashkët ose për të përfunduar një detyrë, me secilin student që kontribuon në këndvështrimet dhe aftësitë e tyre unike.

Këtu janë disa strategji për përfshirjen e të nxënit bashkëpunues në mësimin e EMI-t:

- **Veprimtari me bashkim pjesësh figure:** Ndani klasën në grupe të vogla dhe caktojini secilin grup një tekst të ndryshëm mediatik për ta analizuar, si për shembull një artikull lajmesh, videoklip ose postim në media sociale. Brenda secilit grup, caktoni role të ndryshme për secilin

student, si studiues, përmbledhës, përkthyes dhe prezantues. Pasi secili grup të ketë analizuar tekstin e tij, kërkojuni atyre të ndajnë gjetjet e tyre me të gjithë klasën për të kuptuar më gjerë mesazhet e medias.

- **Krijimi i mediave në bashkëpunim:** Caktoni grupe të vogla për të krijuar tekstet e tyre mediatike, të tilla si një artikull lajmesh, video ose podcast. Nxitni studentët të hulumtojnë, analizojnë dhe kritikojnë tekstet ekzistuese të medias përpara se të krijojnë të tyret. Çdo anëtar i grupit mund të marrë një rol të ndryshëm, si studiues, shkrimtar, redaktor ose producent dhe të bashkëpunojë për të krijuar një produkt përfundimtar.
- **Rishikimi nga kolegët:** Kërkojuni nxënësve të punojnë në dyshe ose grupe të vogla për të analizuar dhe kritikuar projektet mediatike të njëri-tjetrit. Nxitni studentët të japin reagime konstruktive bazuar në konceptet dhe aftësitë e edukimit mediatik që kanë mësuar në klasë.
- **Raste studimore:** Caktoni grupe të vogla për të analizuar dhe diskutuar raste studimore të mesazheve mediatike që kanë shkaktuar polemika ose debat publik. Nxitni studentët të përdorin aftësitë e të menduarit kritik për të analizuar mesazhet e medias, për të marrë parasysh këndvështrime të shumta dhe për të reflektuar mbi ndikimin e mesazheve të medias tek individët dhe shoqëria.

Përmes të mësuarit bashkëpunues, studentët mund të zhvillojnë një kuptim më të thellë të mesazheve mediatike, të ndërtojnë aftësi të të menduarit kritik dhe të mësojnë se si të komunikojnë dhe bashkëpunojnë në mënyrë efektive me të tjerët.

3.5 Të mësuarit e EMI-t përmes analizës së tekstit

Mësimdhënia e medias dhe informacionit përmes analizës së tekstit është një mënyrë efektive për të ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik dhe të bëhen konsumatorë më të zgjuar të medias.

Këtu janë disa këshilla se si ta bëni këtë:

- ❖ **Zgjidhni një tekst përkatës:** që lidhet me interesat e studentëve tuaj. Ky mund të jetë një artikull lajmesh, një postim në rrjetet sociale ose një videoklip.
- ❖ **Prezantoni konceptet e EMI-t:** Përpara se të analizoni tekstin, prezantoni konceptet kryesore të EMI-t si paragjykimi, besueshmëria dhe propaganda. Përcaktoni qartë çdo koncept dhe jepni shembuj.
- ❖ **Analizoni tekstin:** Kërkojuni studentëve të analizojnë tekstin duke përdorur konceptet EMI-t që keni prezantuar. Për shembull, mund

t'u kërkoni atyre të identifikojnë paragjykimet e autorit, të vlerësojnë besueshmërinë e burimeve të cituara dhe të kërkojnë ndonjë teknikë propagande të përdorur.

- ❖ **Diskutoni përfundimet:** Pasi studentët të kenë analizuar tekstin, drejtoni një diskutim në klasë për përfundimet e tyre. Nxitni studentët të ndajnë vëzhgimet e tyre dhe të sfidojnë idetë e njëritjetrit.
- ❖ **Reflektoni mbi përdorimin personal të medias dhe informacionit:** Nxitni studentët të reflektojnë mbi përdorimin e tyre të medias dhe informacionit dhe se si media që ata konsumojnë mund të ndikojë në të menduarit e tyre.
- ❖ **Përsëriteni procesin:** Përsëriteni këtë proces me tekste të tjera për të përforcuar aftësitë dhe konceptet e EMI-t.

Përmes analizës së tekstit, ju mund t'i ndihmoni studentët tuaj të bëhen konsumatorë më kritikë të medias dhe të zhvillojnë aftësi që do t'u shërbejnë atyre mirë në epokën dixhitale.

3.6 Të mësuarit e EMI-t përmes analizës kontekstuale

Mësimdhënia e medias dhe informacionit përmes analizës kontekstuale përfshin shpjegimin e mënyrës se si krijohen, ndërtohen dhe shpërndahen mesazhet mediatike, dhe si mund t'i analizojnë në mënyrë kritike këto mesazhe për të vlerësuar saktësinë, besueshmërinë dhe paragjykimet e mundshme të tyre.

Këtu janë disa hapa që mund të ndiqen për të mësuar EMI-n përmes analizës kontekstuale:

- o **Kuptoni peizazhin mediatik:** Hapi i parë është kuptimi i llojeve të ndryshme të platformave mediatike, të tilla si mediat e shkruara, audiovizive dhe dixhitale. Kuptimi i formateve dhe mediumeve të ndryshme të përdorura nga organet e medias mund t'i ndihmojë studentët të kuptojnë se si krijohen dhe shpërndahen mesazhet.
- o **Kuptoni rolin e medias:** Hapi i dytë është kuptimi i rolit të medias në shoqëri. Kjo përfshin ndihmën e studentëve për të kuptuar ndikimin që media ka në formësimin e opinionit dhe qëndrimeve publike, si dhe implikimet sociale, kulturore dhe politike të mesazheve mediatike.
- o **Identifikimi i paragjykimeve mediatike:** Hapi i tretë është të ndihmojmë studentët që të identifikojnë paragjykimet e medias. Kjo përfshin mësimin e tyre se si të identifikojnë modelet e raportimit ose inkuadrimit të njëanshëm dhe si të identifikojnë informacionet e pasakta, të njëanshme apo të manipuluar.

- o **Analizoni kontekstin:** Hapi i katërt është të ndihmoni studentët të analizojnë kontekstin e mesazheve mediatike. Kjo përfshin analizimin e audiencës së synuar, kontekstit historik dhe kulturor dhe kontekstin social dhe politik në të cilin u krijua mesazhi.
- o **Vlerësoni besueshmërinë:** Hapi i pestë është të ndihmoni studentët të vlerësojnë besueshmërinë e burimeve të medias. Kjo përfshin të mësuarin e tyre se si të identifikojnë burime të besueshme dhe si të vlerësojnë saktësinë dhe vërtetësinë e informacionit të paraqitur në mesazhet mediatike.
- o **Zhvillimi i aftësive të të menduarit kritik:** Hapi i fundit është të ndihmoni studentët të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik. Kjo përfshin nxitjen e tyre për të vënë në dyshim supozimet, paragjykimet dhe vlerat që qëndrojnë në themel të mesazheve mediatike dhe për të vlerësuar besueshmërinë e burimeve.

Të mësuarit përmes analizës kontekstuale kontribuon në zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik të nevojshme për të analizuar dhe vlerësuar mesazhet mediatike. Duke kuptuar kontekstin në të cilin krijohen dhe shpërndahen mesazhet mediatike, individët mund të bëhen konsumatorë më të informuar të medias dhe më të aftë për të vlerësuar saktësinë, besueshmërinë dhe paragjykimet e mundshme të mesazheve mediatike.

3.7 Të mësuarit e EMI-t përmes përkthimeve

Përkthimi mund të jetë një mënyrë efektive për t'i ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik dhe të kuptojnë se si mesazhet mediatike ndërtohen dhe transmetohen nëpër gjuhë dhe kultura të ndryshme.

Këtu janë disa qasje të mundshme për realizimin e EMI-t përmes përkthimit:

Analiza krahasuese: Kërkojuni studentëve të krahasojnë dhe të bëjnë dallimin e teksteve mediatike (p.sh., artikuj lajmesh, reklama, postime në media sociale) në dy ose më shumë gjuhë. Kërkojuni të identifikojnë dallimet në tonin, stilin, mesazhet dhe referencat kulturore. Kjo mund t'i ndihmojë studentët të zhvillojnë një kuptim më të gjerë të mënyrës se si mesazhet mediatike përshtaten me audienca dhe kontekste specifike.

Ushtrime përkthimi: Sigurojuni studentëve tekste mediatike në një gjuhë dhe kërkojuni ta përkthejnë në një gjuhë tjetër. Nxitini ata të marrin në konsideratë se si zgjedhjet gjuhësore (p.sh., idioma, metaforat, loja e fjalëve) mund të ndikojnë në kuptimin dhe interpretimin e mesazhit.

Zbërthimi i mesazheve mediatike: Kërkojuni studentëve të analizojnë tekstet mediatike në gjuhën e tyre origjinale dhe më pas t'i përkthejnë ato në një gjuhë tjetër. Kjo mund t'i ndihmojë ata të identifikojnë se si disa fjalë, fraza ose referenca kulturore mund të humbasin ose

shtrembërohen në përkthim dhe se si kjo mund të ndikojë në kuptimin e përgjithshëm të mesazhit.

Edukim për ndjeshmërinë kulturore: Përfshini diskutimet rreth dallimeve kulturore dhe paragjyqimeve në mësimet e EMI-t. Ndhmójini studentët të zhvillojnë një vetëdije se si supozimet dhe stereotipat kulturorë mund të ndikojnë në mesazhet mediatike dhe se si përkthimi mund të përdoret për të sfiduar ose përforcuar këto supozime.

Të mësuarit përmes përkthimit mund t'i ndihmojë studentët të zhvillojnë aftësi të të menduarit kritik, ndërjegjësim ndërkulturor dhe një kuptim më të thellë të mënyrës se si mesazhet mediatike ndërtohen dhe transmetohen në gjuhë dhe kultura të ndryshme.

3.8 Të mësuarit e EMI përmes Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

Të mësuarit përmes teknologjisë së informacionit mund të jetë një mënyrë efektive për të ndihmuar studentët të bëhen konsumatorë më kritikë të medias dhe të zhvillojnë aftësi të rëndësishme dixhitale. Këtu janë disa ide se si të mësohet EMI përmes teknologjisë së informacionit:

Analizoni burimet e lajmeve në internet: Mësojini studentëve si të vlerësojnë burimet e lajmeve në internet

për besueshmërinë, paragjykimet dhe saktësinë. Jepuni atyre mjete dhe faqe interneti për verifikimin e fakteve që mund t'i ndihmojnë ata të verifikojnë informacionin.

Krijoni projekte multimediale: Nxitni studentët të krijojnë projekte multimediale, të tilla si video ose podkaste, që analizojnë mesazhet mediatike dhe ndikimin që ato kanë në shoqëri. Këto projekte mund të ndahen në internet për të promovuar qytetarinë dixhitale dhe për të arritur një audiencë më të gjerë.

Analiza e mediave sociale: Mësojini studentët se si të analizojnë platformat e mediave sociale për saktësinë, besueshmërinë dhe paragjykimet e mundshme. Nxitini ata të përfshihen në diskutime kritike rreth ndikimit të mediave sociale në shoqëri.

Njohuri në internet: Mësojini studentët si të lundrojnë në internet, të gjejnë burime të besueshme dhe të njohin dhe shmangin lajmet e rreme dhe dezinformacionet.

Qytetaria dixhitale: Ndihmoni studentët të zhvillojnë aftësi të mira të qytetarisë dixhitale, të tilla si respektimi i privatësisë të të tjerëve në internet dhe mbrojtja e informacionit të tyre personal.

E drejta e autorit dhe përdorimi i drejtë: Informoni studentët për ligjet për të drejtat e autorit dhe përdorimin e drejtë të mediave, duke përfshirë imazhet dhe videot, në mënyrë që ata të mund të përdorin median dixhitale në mënyrë legale dhe etike.

Tregimi dixhital: Nxitni studentët të përdorin mjete dixhitale për të krijuar dhe ndarë historitë e tyre, duke promovuar njëkohësisht EMI-n dhe të nxënit dixhital.

Përmes zbatimit të këtyre strategjive, pedagogët mund t'i ndihmojnë studentët të bëhen konsumatorë më të zgjuar të medias, të promovojnë qytetarinë dixhitale dhe të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për sukses në një botë dixhitale.

3.9 Të mësuarit e EMI-t përmes eksperimenteve

Të mësuarit përmes eksperimenteve mund të jetë një mënyrë krijuese dhe tërheqëse për t'i ndihmuar studentët të kuptojnë se si media dhe informacioni ndikojnë në perceptimet, qëndrimet dhe sjelljet tona. Këtu janë disa ide për eksperimente që mund të përdoren gjatë procesit të mësimdhënies:

Ndikimi i shenjave vizuale: Ky eksperiment mund të përdoret për t'i ndihmuar studentët të kuptojnë se si sinjalet vizuale mund të ndikojnë në perceptimin tonë të realitetit. Për shembull, ju mund t'u tregoni studentëve dy imazhe të të njëjtit person, një me një shprehje të lumtur dhe një me një shprehje të trishtuar. Kërkojuni studentëve të përshkruajnë personin në çdo imazh dhe se si ndihen për të. Më pas mund të zbuloni se të dyja imazhet janë të të njëjtit person, por me shprehje të ndryshme. Ky eksperiment mund të përdoret për të demonstruar se si media mund të manipulojë emocionet tona dhe të ndikojë në perceptimet tona.

Ndikimi i stereotipizimit: Ky eksperiment mund të përdoret për të ndihmuar studentët të kuptojnë ndikimin e stereotipizimit në media. Ju mund t'u tregoni studentëve dy reklama për të njëjtin produkt, njëra me një paraqitje stereotipike të një grupi të caktuar dhe tjetra me një përfaqësim më të larmishëm. Kërkojuni studentëve të përshkruajnë ndryshimet midis dy reklamave dhe se si ndihen për secilën prej tyre. Ky eksperiment mund të përdoret për të demonstruar se si media mund të përjetësojë stereotipe të dëmshme dhe të ndikojë në qëndrimet dhe bindjet tona.

Roli i paragjyimit të konfirmimit: Ky eksperiment mund të përdoret për të ndihmuar studentët të kuptojnë se si paragjykimi i konfirmimit mund të ndikojë në konsumin tonë të medias. Ju mund t'u kërkonit studentëve të zgjedhin një lajm me të cilin nuk janë dakord dhe të gjejnë një burim mediatik që paraqet një këndvështrim tjetër.

Kërkojuni studentëve të krahasojnë dy histori dhe të identifikojnë çdo paragjykim që mund të jetë i pranishëm. Ky eksperiment mund të përdoret për të demonstruar sesi paragjykimi i konfirmimit mund të ndikojë në besimet tona dhe në perceptimin tonë të realitetit.

Përmes kësaj metode, studentët mund të zhvillojnë aftësi të të menduarit kritik, të bëhen më të vetëdijshëm për manipulimin e informacionit në media dhe të bëhen konsumatorë më të përgjegjshëm të saj.

IV. Sugjerime për hartimin e programit të lëndës së EMI-t

Objektivi kryesor në hartimin e programit të lëndës duhet të jetë, përfshirja e njohurive bashkëkohore në fushën e medias dhe informacionit dhe aftësimi i studentëve me kompetenca që nevojiten sot për t'u angazhuar me përmbajtjen, ndaj së cilës ekspozohemi përmes teknologjive dhe burimeve të shumta¹⁸ të informacionit. Lektorët që do të angazhohen në përgatitjen e planit dhe programit të lëndës duhet që krahas njohurive rreth burimeve tradicionale të informacionit, të përfshijnë njohuri mbi rolin e inteligjencës artificiale, algoritmeve dhe të dhënave në ekosistemin e ri të informacionit. Studentët e programeve të edukimit, të cilët do të jenë mësuesit e ardhshëm duhet të kenë njohuri për format dhe logjikën e re të medias në epokën digjitale¹⁹.

18 *Media and information literate citizens: think critically, click wisely!* UNESCO, 2021 (<https://creativecommons.org/licenses/by-sa/3.0/igo/>).

19 *The Routledge Handbook of Media Education Futures Post-Pandemic*, Edited by Yonty Friesem, Usha Raman, Igor Kanižaj and Grace Y. Choi, Routledge, 2023, New York

4.1 Si mund të emërtohet lënda?

Për emërtimin e lëndës mund të ndiqet Korniza e Kompetencave EMI të UNESCO-s, që kombinon tri zona të dallueshme – aftësi për median, aftësi për informacionin, aftësi dixhitale – nën një term gjithëpërfshirës: edukimi për median dhe informacionin. Brenda edukimit mbi median, përfshihet edhe edukimi rreth lajmit, ndërsa si pjesë e edukimit mbi informacionin, mund të integrohet edukimi dixhital dhe njohuritë për internetin, si dhe përmbajtje të tjera që ofrohen në rrjet. Duke mbajtur parasysh këtë qasje, emërtimi më i përshtatshëm për lëndën mund të jetë, Edukimi mbi Median dhe Informacionin (EMI).

4.2 Në cilin cikël studimi mund të ofrohet?

Lënda e Edukimit mbi median dhe informacionin mund të ofrohet si në ciklin e parë të studimeve ashtu edhe në ciklin e dytë. Në kuadër të studimeve në nivelin bachelor, EMI mund t'u ofrohet studentëve si lëndë me zgjedhje, e cila përfshihet në kategorinë "C" (Lëndë ndërdisiplinore/integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje), sipas parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. Nr. 879, datë 18.12.2019. Ofrimi si lëndë me zgjedhje brenda kurrikulës trevjeçare, krijon fleksibilitet për njësitë bazë të cilat mund ta përfshijnë të njëjtën lëndë në të gjitha programet e studimit që

ofrohen nga njësia. Në rastin kur njësia bazë ka disa programe studimi apo profile në fushën e mësuesisë, të njëjtën lëndë me zgjedhje, me të njëjtën ngarkesë, mund ta marrin studentët e programeve të ndryshme. Në këtë rast lektorët apo udhëheqësit e grup-lëndëve duhet të mbajnë parasysh zgjedhjen e temave, të cilat duhet të përshtaten me specifikat e secilit program apo profil studimi. Ashtu si në rastin e programeve të ciklit të parë, edhe në programet master mund të përfshihet lënda e Edukimit mbi Median dhe Informacionin. Në programet master përmbajtja e lëndës duhet të parashikojë me kujdes profilin e studimeve dhe të përshtatet si në objektiva dhe në rezultate, ashtu edhe në tematika me veçoritë e programit.

4.3 Sa është ngarkesa e rekomanduar e lëndës?

Ngarkesa e lëndës së EMI në kredite në rastin ku ajo ofrohet si lëndë e veçantë duhet të marrë parasysh ngarkesën e përgjithshme të grup-lëndëve me zgjedhje brenda një programi studimi.

Në varësi të objektivave të programit të studimit, lënda e EMI-it mund të ketë ngarkesë nga 3 - 5 ECTS. Ngarkesa në çdo rast, pavarësisht nga numri i ECTS-ve, duhet të ketë një ndarje të balancuar mes angazhimit në auditor dhe angazhimit jashtë auditorit. Kjo ngarkesë duhet të ndahet në leksione, seminare dhe ushtrime apo punët në laborator. Në rastin kur lënda është parashikuar

me 5 ECTS, atëherë ngarkesa semestrare e lëndës është 125 orë, e ndarë në 48 orë në auditor dhe 77 orë studim individual.

Nëse njësia bazë në universitet zgjedh të integrojë EMI sipas qasjes ndërlëndore më të dyja format e aplikimit të saj, atëherë ngarkesa duhet të marrë parasysh objektivat që synohen të arrihen përmes temave të EMI-t. Sugjerimi në këtë rast është që lektori i lëndëve ku mendohet të integrohen temat e EMI-it, të ndajë në mënyrë të balancuar ngarkesën mes temave të parashikuara në silabus.

4.4 Çfarë kualifikimi duhet të kenë lektorët?

Lektorët e angazhuar në mësimdhënie në kuadër të EMI-it, duhet të kenë njohuri të mjaftueshme nga fusha, të njohin qasjet pedagogjike të përshtatshme për lëndën dhe të jenë të qartë për rezultatet e të nxëniet të studentëve. Fakultetet dhe departamentet e edukimit, mund të angazhojnë si mësimdhënës stafin që ka kualifikimin më të plotë në këtë fushë.

Një alternativë e përshtatshme për të lektuar në këtë fushë janë pedagogët e lëndëve të formimit bazë të tilla si "Metodologjia e kërkimit shkencor" apo lëndët e formimit të përgjithshëm, që përfshihen në kategorinë "A" të grup-lëndëve.

Një mënyrë tjetër mund të jetë huazimi i lektorëve nga fusha e komunikimit dhe medias në rastet kur Institucioni i arsimit të lartë ka në përbërjen e tij

pedagogë të këtij formimi akademik. Kjo mund të bëhet e mundur me një bashkëpunim mes njërive kryesore apo njërive bazë, duke mundësuar që lëndën e EMI-it ta japin lektorët me formim akademik në fushën e komunikimit, medias apo gazetarisë. Megjithatë nëse shkohet drejt kësaj zgjidhjeje është e rëndësishme që programi i lëndës të konsultohet dhe hartohet në bashkëpunim me njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Ky bashkëpunim është i nevojshëm për të ndërtuar një program lënde të përshtatshëm me nevojat e studentëve në programet e edukimit.

4.5 Si të përcaktohet qëllimi i lëndës në përputhje me programin e studimit?

Për përcaktimin e objektivave të lëndës, parimi i parë që duhet mbajtur parasysh është integrimi me objektivat e përgjithshme të programit të studimit. Më konkretisht, nëse në objektivat e programit përfshihet aftësimi i studentëve në përdorimin efektiv të informacionit dhe zhvillimin e mendimit kritik, atëherë ky objektiv mund të përfshihet brenda listës së objektivave të lëndës së EMI-it. Objektivat duhet të hartohen bazuar në modelin e ndjekur për hartimin e programit të lëndës. Për shembull, nëse grupi i punës vendos të ndjekë modelin e bazuar në kompetenca, objektivat duhet të parashikojnë përvetësimin e këtyre kompetencave nga ana e studentëve.

4.6 Si të përcaktohen rezultatet e të nxënit për EMI-n?

Ngjashëm me modelet pedagogjike ekzistuese, rezultatet e të nxënit edhe në fushën e edukimit për median dhe informacionin mund të grupohen në tre kategori bazë:

Në kategorinë I studentët duhet të:

- Identifikojnë mesazhet e medias
- Ilustrojnë pjesë të informacionit
- Përmbledhin informacion nga burime të ndryshme
- Klasifikojnë mediumet e ndryshme

Në kategorinë II studentët duhet të:

- Përdorin mediumet e ndryshme
- Dallojnë informacionet e rreme nga të vërtetat
- Analizojnë formate dhe produkte të ndryshme mediatike
- Krahasojnë përmbajtje të ndryshme mediatike

Në kategorinë III studentët duhet të:

- Monitorojnë media të ndryshme lidhur më një ngjarje
- Gjykojnë mbi kriteret e gazetarisë
- Prodhonjë përmbajtje origjinale mediatike
- Hartojnë projekte për analiza mediatike

Sa i përket formës së vlerësimit të studentëve, në lëndën Edukimi mbi Median dhe Informacionin, sugjerohet që vlerësimi të bëhet si për lëndët e tipologjisë II, çka nënkupton se duhen integruar disa komponentë vlerësimi si për aftësitë teorike, ashtu edhe për ato praktike. Në përputhje me sistemet e vlerësimeve të fakulteteve dhe degëve përkatëse, sugjerohet skema vijuese e vlerësimit:

10% aktivizimi në seminare

20% përfshirja në projekte

30% provimi i ndërmjetëm

40% provimi final

4.7 Tematikat që mund të përfshihen në programin e lëndës

Ndërkohë që Edukimi mbi Median dhe Informacionin po ndryshon dhe pasurohet dita ditës, institucionet arsimore janë në sfidë të vazhdueshme lidhur me relevancën e temave dhe metodikave që duhet të aplikojnë me studentët për përvetësimin e njohurive lidhur me këtë lëmë të dijes. Ky sesion i udhëzuesit synon t'u ofrojë pedagogëve një model silabusi të shtrirë në 14 javë, duke u ndalur në tematikat kryesore, të cilat nuk duhet të mungojnë në një silabus të kësaj lëndë. Tematikat janë orientuese, duke u lënë mundësi pedagogëve të fakulteteve dhe departamenteve përkatës të reflektojnë për një përshtatshmëri më të madhe kurrikulare me fushat ku ata operojnë.

MODEL SILABUSI

Pedagogu:

Ngarkesa:

Tipologjia e lëndës:

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet:

Lloji i lëndës:

Programi i studimit:

Adresa elektronike e pedagogut të lëndës:

Përgjegjësi i Departamentit:

PËRMBLEDHJE DHE QËLLIMET E KURSIT

KONCEPTET THEMELORE KYÇ:

Edukimi për median dhe informacionin

Vërtetësia e Lajmit

Burimet e informacionit

Mediat Online

Tipologjia e Mediave

Chat Gpt dhe IA

TEMAT E KURSIT

Tema 1 – Fuqia e informacionit dhe përgjegjësia e qytetarit dixhital

Tema 2 – Krijimi, shpërndarja dhe fuqia e informacionit. Roli i siguriesve kryesorë të informacionit (media, libraritë, arkivat,

muzetë, kompanitë e komunikimit digjital, interneti) në këtë proces

Tema 3 – Mediat e reja, algoritmet dhe AI (inteligjenca artificiale)

Tema 4 – Vërtetësia/analiza e burimeve

Tema 5 - Çrregullimet e informacionit (keqinformimi, dezinformimi, informimi keqdashës. Manipulimi i informacionit/ Propaganda)

Tema 6 – Lajmi, çfarë është? Cilat janë kriteret për të qenë lajm? Procesi i zhvillimit të lajmeve.

Tema 7 – Gjuha e urrejtjes në dhe përmes medias. Kufijtë mes lirisë së shprehjes dhe censurës

Tema 8 – Përmbajtjet e krijuara nga përdoruesit. Çfarë duhet pasur parasysh?

Tema 9 – Çështje të sigurisë, privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Tema 10 – Standardet etike dhe profesionale në krijimin dhe shpërndarjen e informacionit/ e drejta e autorit/ pronësia intelektuale

Tema 11 – Pesë hapa drejt MIL: aksesoni, analizoni, krijoni, reflektoni, veproni

Tema 12 – Imazhi dhe ideologjia

Tema 13 – Edukimi mbi median dhe kultura popullore/ Cancel culture

Tema 14 – E ardhmja e edukimit mbi mediat dhe informacionin

LITERATURA

a. Literatura bazë e detyrueshme:

Potter, J. (2014) Media Literacy 7th Edition, New York: Sage

"Advertising, Persuasion, and Propaganda." In Reading the Media: Media Literacy in High School English. New York, NY: Teachers College Press, 2007.

Buckingham, D(2003) Media Education: Literacy, Learning and Contemporary Culture. London: Polity

Maicgret, E (2010) Sociologjia e komunikimit: Papirus, Tirane

Domenick, J(2010) Dinamikat e komunikimit masiv bashkëkohor: UETPress: Tirane

Parser, E.. et al (Crowdsourced) (2017) Center for News Literacy Citation

"Think Critically, Click Wisely! Media and Information Literate Citizens", Second Edition of the Unesco Media and Information Literacy Curriculum for Educators and Learners, Alton Grizzle, Carolyn Wilson, Dorothy Gordon, UNESCO 2021

"Artificial intelligence and communication: A Human–Machine Communication research agenda ", Andrea L Guzman, Seth C Lewis, New Media and Society, 2020, Vol. 22(1) 70–86

"Media and information literacy, A practical guidebook for trainers ", Sylvia Braesel, Thorsten Karg, Edition DW Akademie, 2021

Media Literacy, Eighth Edition, W. James Potter, Sage Publishing, 2016

Understanding New Media, SECOND EDITION, Eugenia Siapera, Sage Publishing, 2018

Digital Media&Society, Simon Lindgren, Sage Publishing, 2017

Understanding Digital Literacies. A practical Introduction, Second Edition, Rodney H. Jones and Christoph A. Hafner, Routledge, 2021

Balkan Insight, <https://balkaninsight.com/2020/11/04/fake-news-rivals-real-news-for-albanians-reading-about-covid/>

Adresimi i dezinformacionit dhe teorive të konspiracionit, ISHM, <https://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2021/11/Cela-Covid-Final-me-ISBN-1.pdf>

Conspiracies and COVID19 in the Balkans, <https://biepag.eu/wp-content/uploads/2021/07/Conspiracies-and-COVID19-in-the-Balkan-English-2.pdf>

Mapping Fake News and Disinformation in the Western Balkans, European Parliament, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU\(2020\)653621_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU(2020)653621_EN.pdf) Distracted and distractible': The rise of propaganda, <https://www.streetroots.org/news/2017/03/16/distracted-and-distractible-rise-propaganda>

Si të dallojmë propagandën, <https://faktoje.al/manipulimi-i-opinionit-publik-si-te-dallojme-keqinformimin-disinformimin-dhe-propaganden/> Manual për Trajnimin dhe Formimin e Gazetarëve, UNESCO, <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000373875>

ÇRREGULLIMI INFORMATIV: Drejt një kuadri ndërdisiplinar për studime dhe politikëbërje, COE, <https://rm.coe.int/crregullimi-informativ-final-01102019/1680989a70>

Fjalorth për çrregullimin informativ, <https://www.reporter.al/2019/12/14/fjalorth-i-vogel-i-dizinformimit-online/>

Gjuha e urrejtjes, propaganda dhe dezinformimi, <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2020/12/Resilience-publication-1-ALB-.pdf>

b. Literatura e rekomanduar dhe burime shites

Gee, James Paul. "Literacy and the Literacy Myth." In *Social Linguistics and Literacies*. London, England: Routledge, 1996. ISBN: 9780748404995. Shaughnessy, Michael dhe Stadler, Jane (2012). *Media & Society*, 5e. London. Oxford Press.

<https://doaj.org/>

<http://lareferencia.info/es>

https://en.unesco.org/sites/default/files/belgrade_recommendations_on_draft_global_standards_for_mil_curricula_guidelines_12_november.pdf

<https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000224655>

<https://en.unesco.org/gamagandunitëin>

Vërtet i verifikuar, <http://verified-albania.org/>

Center for Media Literacy <https://www.medialit.org/>

Learn to discern media literacy curriculum <https://www.irex.org/project/learn-discern-l2d-media-literacy-training>

V. Sugjerime për planifikimin e integrimit ndërlëndor të EMI

Referuar modeleve dhe praktikave më të mira të integrimit të edukimit për median dhe informacionin në shkolla dhe universitete, ka rezultuar se përveç ofrimit si një lëndë më vetë, në një nga ciklet e studimit, **integrimi si modul** dhe **integrimi i EMI-t në lëndët ekzistuese**, janë dy qasje, të cilat rrisin ndjeshëm njohuritë që studentët mund të marrin në këtë fushë. Integrimi si modul nënkupton që 3 deri në 4 tema të kursit t'i dedikohen specifikisht edukimit për median dhe informacionin, ndërsa **qasja e dytë** nuk e limiton pedagogun në një numër javësh, por i jep mundësi që në të gjitha javët semestrale, EMI të ndërthuret lehtësisht me lëndët e tjera. Më poshtë ofrohen shembuj konkretë se si mund të operohet në secilën prej qasjeve.

5.1 Si të planifikoni integrimin e EMI-t në lëndët ekzistuese?

Integrimi i një moduli, me disa tema të veçanta brenda silabusit të një lëndë specifike, e cila ka ngarkesën e krediteve sipas veçorive të programit të studimit, u lejon pedagogëve të pasurojnë lëndën, si në teori ashtu edhe praktikë. Në këtë rast, pedagogu i lëndës përfshin në

programin e lëndës disa tema që i konsideron si më të rëndësishmet dhe më të dobishmet për studentët, të cilat konvergojnë dhe përshtaten me temat e tjera të lëndës.

Më konkretisht, integrimi i një modul 3-4 javor i EMI-t duhet të kalojë në këto hapa:

- I: Rishikoni programin e lëndëve për të shqyrtuar se ku mund të integrohet më mirë EMI, si në shtrirje kohore ashtu edhe në atë tematike.*
- II: Kushtojini ¼ e kursit tuaj këtij moduli, për t'i dhënë studentëve kohë të përvetësojnë konceptet kryesore të kësaj fushe.*
- III: Parashikoni përfshirjen e të ftuarve/ ekspertëve të jashtëm për të pasuruar materialet dhe diskutimin brenda klasës.*
- IV: Hartoni një plan të kujdesshëm lidhur me temat, të cilat duhet të jenë patjetër pjesë e këtij moduli, për të siguruar që studentët të jenë prezantuar me nocionet kryesore të EMI-t.*

Qasja e dytë, i fton studentët në një reflektim më gjithëpërfshirës të të kuptuarit se si prodhohet dhe vlerësohet informacioni, si edhe përdorimin e informacionit në krijimin e njohurive të reja dhe pjesëmarrjen në komunitetet e të mësuarit. Kjo qasje kërkon një përpjekje më të qenësishme pedagogjike, sepse kërkon prej pedagogut të një lëndë të caktuar, ta rikonceptojë kursin, duke pasur në mendje se një nga rezultatet kryesore të të nxënit, do të lidhet specifikisht me rritjen e njohurive për edukimin mbi median dhe informacionin. Më poshtë jepen 3 modele sesi EMI mund të integrohet me fusha/ lëndë të ndryshme:

Modeli 1: Lidhja e EMI-t me humanitetet

Edukimi mbi Median dhe Informacionin u ofron humaniteteve shumë njohuri të domosdoshme. Përveç lidhjes së natyrshme me komunikimin, ajo mund të përdoret si një metodë pedagogjike në disa lëndë të kësaj fushe studimi. Për shembull kur studenti kryen një kërkim shkencor, i duhet të analizojë ligjërimet mediatike, të punojnë me mediumet e ndryshme, etj. Përdorimi i filmave, arkivave, materialeve print ose online janë një pasuri e madhe metodike për të zhvilluar mësimin në lëndët e përmendura më sipër.

Më konkretisht në mësimin e Gjuhës dhe Letërsisë janë një sërë njohurish të EMI-t që përdoren të tilla si:

- Tekstet mediatike print ose online
- Ligjërimet e hapësirës publike
- Analiza e veprave letrare të ekranizuara
- Lëvrimi i gjuhës në medime të ndryshme
- Raportet ligjërimore
- Interpretimet e shumëfishta të tekstit letrar

Shembull I

Diskutoni për ligjërimet identitare të veprës së Kadaresë duke u bazuar në kritikën e botuar në revistat letrare

Shembull II

Analizoni ekranizimin e veprës së Jane Austen dhe dallimet e tij me tekstin

Shembull III

Analizoni respektimin e parametrevë gjuhësorë nga politikanët shqiptarë në rrjetet sociale

Modeli 2: Lidhja e EMI-t me Shkencat ekzakte

Pandemia vërtetoi se edukimi për median dhe informacionin është një aftësi e rëndësishme për të marrë vendime të mençura në kohë krizash globale. Ngrohja globale dhe të tjera dukuri natyrore dhe fizike, na kanë treguar sesi informacioni i gabuar, mund të lërë pasoja të mëdha materiale dhe jo materiale. Thënë kjo, lëndë si biologjia, matematika, fizika etj, jo vetëm që mund të ndërlidhen me EMI-n për të organizuar orë produktive laboratorike, por mund t'i ndihmojnë studentët të kuptojnë më mirë të dhënat dhe informacionet që marrin nga këto shkencë, duke e përdorur EMI-n si një qasje pedagogjike.

Më konkretisht, në lëndën e matematikës mund të përdorin një sërë materialesh të EMI-t në zhvillimin e orëve të leksionit si:

- Filmat dhe dokumentarët
- Reklamat dhe vlefshmëria e testeve shkencore
- Gazetat dhe revistat që ofrojnë të dhënat

Shembull I

Matematika në reklamat e telefonit ose të kartave të kreditit

Shembull II

Analizoni informacionet ekonomike në lajme dhe mënyrën se si serviren ato

Shembull III

Analizoni filmin "A beautiful mind"

Modeli 3: Lidhja e EMI-t me Shkencat sociale

Edukimi për Median dhe Informacionin është pa dyshim një shqetësim social dhe sa më shumë qytetarë të ndërgjegjësuar të keni lidhur me rëndësinë e saj, aq më shumë do të rriten shanset për një shoqëri të hapur dhe demokratike. Thënë kjo, kurset e lëndëve si sociologjia, psikologjia, filozofia etj., janë një platformë ideale, ku mund t'u mësojmë studentëve se si të jenë qytetarë më produktivë, çka nënkupton një proces të gjerë të të kuptuarit dhe të reflektimit mbi vendimmarrjen, detyrat qytetare dhe ekonominë e qëndrueshme.

Duke pasur parasysh këto kushte, EMI ofron një larmishmëri temash dhe metodash, të cilat mund të integrohen në mësimdhënien dhe mësimnxënien në fushën e shkencave sociale si:

- Revistat shkencore dhe kërkimet/ gjetjet shkencore në këtë fushë
- Dezinformimi, faktet dhe trillimi
- Analiza e teksteve, fjalorëve dhe dokumenteve për të kuptuar ligjërimet
- Filmat si ndërtues të identitetit dhe gjinisë

Shembull I

Analizoni mesazhet politike gjinore tek versionet e reja të filmave vizatimore

Shembull II

Analizoni ndërtimet sociologjike të racës dhe etnisë në filmat e vjetër të Hollivudit

Shembull III

Analiza e paragjytimeve dhe stereotipave të medias për njerëzit me aftësi ndryshe, komuniteti LGBT, emigrantët etj. Studentët mund të analizojnë se si përfaqësimet mediatike kontribuojnë në përjetësimin e stereotipeve dhe se si media mund të përdoret për të sfiduar dhe ndryshuar këto portretizime, duke u ndalur specifikisht në serialet e prodhuara nga Netflix.

5.2 Si ta bëni EMI pjesë të qasjes pedagogjike?

5.2.1 EMI si mënyrë për të aksesuar dhe vlerësuar burime të ndryshme informacioni

EMI mund të luajë një rol kritik për t'i ndihmuar studentët të kenë akses dhe të dinë të vlerësojnë nga shumë këndvështrime burime të ndryshme informacioni.

Studentët nëpërmjet lëndëve të ndryshme ose nën një lëndë të mirëfilltë të Edukimit mbi Median dhe Informacionin nxiten të pajisen me njohuri mediatike dhe aftësi për të analizuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike mesazhet mediatike. Duke zhvilluar këto aftësi, studentët mund të mësojnë se si të aksesojnë dhe interpretojnë lloje të ndryshme mediash, përfshirë artikujt e lajmeve, faqet e internetit, videot dhe postimet në media sociale, si edhe të identifikojnë lajmet e rreme

dhe dezinformacionet, të cilat mund t'i pengojnë ata të kenë akses në burime jo të besueshme informacioni.

Gjatë gjithë lëndëve, përmes kërkimit shkencor, EMI mëson studentët se si të kryejnë kërkime efektive, duke përfshirë mënyrën e përdorimit të llojeve të ndryshme të burimeve, si librat, revistat akademike dhe bazat e të dhënave në internet. Aftësitë kërkimore mund t'i ndihmojnë studentët të kenë akses dhe të vlerësojnë informacionin e saktë dhe të besueshëm.

Nëpërmjet EMI-t si lëndë më vete ose të integruar në lëndë të ndryshme, teksa zhvillojnë aftësitë e përdorimit të medias dhe informacionit, studentët mësojnë se si të përdorin mjete të ndryshme dixhitale, të tilla si motorët e kërkimit, bazat e të dhënave në internet dhe platformat e mediave sociale. Të gjitha këto do t'ju duhen më pas për t'i përdorur në studimet e tyre për të kuptuar çështjet që lidhen me privatësinë dhe sigurinë dixhitale, të cilat mund të jenë të rëndësishme kur aksesojnë informacionin në internet.

Studentët, nëpërmjet EMI-t duhet të nxiten për të zhvilluar aftësinë për të pyetur dhe analizuar burimet e informacionit, për të identifikuar çdo paragjykim ose supozim që mund të jetë i pranishëm në informacion dhe për të vlerësuar saktësinë dhe rëndësinë e informacionit. Të kuptojnë dallimet midis llojeve të ndryshme të burimeve, të tilla si artikujt shkencorë, artikujt e lajmeve dhe blogjet, dhe të dinë se si të vlerësojnë besueshmërinë e burimeve si të kuptuarit e reputacionit të botuesit ose autorit, kontrollimin e provave për të mbështetur pretendimet dhe kërkimin e konfliktit të interesit.

5.2.2 EMI si qasje për të nxitur zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik

Kjo qasje ka të bëjë me adoptimin e EMI-it si qasje pedagogjike në zhvillimin e lëndëve të ndryshme në të dy ciklet e studimit. Në këtë rast kemi të bëjmë me metodologji mësimdhënieje dhe jo thjesht me integrimin e njohurive specifike në listën e temave që ka një program lënde.

Në të dyja rastet, ku kemi të bëjmë me integrimin e tematikave të EMI-t brenda lëndëve ekzistuese, lektori i lëndës duhet të mbajë parasysh rishikimin e objektivave të lëndës dhe rezultateve të të nxënit. Kjo do të thotë që njohuritë për EMI-n të parashikohen brenda grupit të objektivave specifike të lëndës dhe të reflektohen në rezultatet e pritshme të të nxënit, si dhe kompetencat që parashikohet të përfitojë studenti. Është e nevojshme që rezultatet e të nxënit të jenë në kohezion me rezultatet e përgjithshme të programit të studimit.

EMI është një mënyrë efektive për të nxitur mendimin kritik të studentëve.

Nëpërmjet EMI-t studentët mund të mësojnë se si të vlerësojnë në mënyrë kritike mesazhet mediatike dhe të identifikojnë çdo paragjykim ose supozim që mund të jetë i pranishëm. Lektori, duhet të nxisë të menduarit kritik duke promovuar një kuptim më të thellë të çështjeve që diskutohen dhe duke nxitur studentët të vënë në dyshim informacionin që hasin duke parashtruar e pyetje dhe kërkuar burime shtesë të informacionit.

5.2.3 EMI si metodë për të nxitur shprehjen dhe krijimtarinë e përmbajtjeve

EMI mund të jetë një metodë e shkëlqyer për të nxitur shprehjen dhe krijimtarinë e përmbajtjes tek studentët. Nëpërmjet aksesit në mjetet krijuese si software të ndryshëm, mediave sociale, forumeve në internet ose mjeteve të bashkëpunimit si Google Docs., mjeteve të dizenjimit grafik etj., metodologjive të përdorimit të medias dhe informacionit, krijimit të informacioneve autentike, studentët mund të krijojnë përmbajtjen e tyre dhe të shprehen në mënyra të reja dhe krijuese, mund të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të krijojnë përmbajtje objektive, analizuuese, të bazuara në fakte dhe të dhëna empirike, etj.

Gjithashtu, studentët duhet të nxiten të promovojnë diversitetin, duke u ofruar mundësi për të shprehur perspektivat dhe përvojat e tyre unike. Kjo mund të bëhet përmes platformave që mbështesin lloje të ndryshme të përmbajtjes si podkaste, blogje dhe kanale video, që i nxisin ata të shprehin zërat e tyre unike dhe të kontribuojnë në një komunitet më të madh krijues.

VI. Referenca

Blumberg, F. C. (2019). *Media literacy for the 21st century: Interview with Renee Hobbs*, EdD. Society for Media Psychology & Technology, Division 46 of the American Psychological Association. Spotlights feature.

Christian, Sue Ellen, *Edukimi mediatik në përditshmëri – Një udhëzues analog për jetën tuaj digjitale*, ISHM, Tiranë, 2022

Gobby, Brad & Millei, Zsuzsa; *Schooling, Its History and Power*; December 2017, Link: https://www.researchgate.net/publication/321491194_Schooling_Its_History_and_Poëer

Media and Information Literacy - Curriculum for Teachers (2011), UNESCO

The Alexandria Proclamation on Information Literacy and Lifelong Learning, (2005), Link: <https://milunesco.unaoc.org/mil-resources/the-alexandria-proclamation-on-information-literacy-and-lifelong-learning-2005/>

Zguri, Rrapo, *Kultivimi i literacisë së Medias dhe të informacionit në mjediset universitare*, ISHM, Tiranë 2022, Link: <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2021/03/Rrapo-Zguri.pdf>

Media Literacy, Tenth Edition, W. James Potter, Sage Publications, 2021

Brad Gobby & Zsuzsa Millei; *Schooling, Its History and Power*; December 2017, Link: https://www.researchgate.net/publication/321491194_Schooling_Its_History_and_Power

Blumberg, F. C. (2019). *Media literacy for the 21st century: Interview with Renee Hobbs*, EdD. Society for Media Psychology & Technology, Division 46 of the American Psychological Association. Spotlights feature.

Media and Information Literacy - Curriculum for Teachers (2011), UNESCO

The Alexandria Proclamation on Information Literacy and Lifelong Learning, (2005), Link: <https://milunesco.unaoc.org/mil-resources/the-alexandria-proclamation-on-information-literacy-and-lifelong-learning-2005/>

